



# College ESLG

## PROCESVERBALI I TAKIMIT TË GRUPIT PUNUES PËR HARTIMIN E RVV PËR PROGRAMIN MENAXHIMI I PATUNDSHMËRIVE DHE INFRASTRUKTURËS (MA)

Date: 06.02.2020

Më 06.02.2020 u mbajt takimi konsultativ i Grupit Punues për hartimin e raportit të vetëvlerësimit për programin studimor master Menaxhimi i Patundshmërive dhe Infrastrukturës (MA). Në takim morrën pjesë: Prof. Asoc. Dr. Visar Hoxha, Prof. Asist. Dr. Islam Hasani, Albina Vuthi (përfaqësuese e studentëve) dhe Eljesa Arifi (përfaqësuese e studentëve).

Pas rishiqimit të raportit të vetëvlerësimit bazuar në standardet e Agjencisë së Akreditimit të Kosovës, secili prej anëtarëve të ekipit punues dha vërejtjet e tij të gjithëmbarshme mbi aspektet e ndryshme të programit studimor dhe pasqyrimin të tyre në kuadër të raportit të vetëvlerësimit RVV.

Pikë e fortë e cila u potencua nga të gjithë e programit studimor është mësimi i bazuar në hulumtim, fokusi në qëndrueshmëri, interdisciplinarteti i lëndëve dhe aktiviteti interdisciplinar i cili është përdorur si pilot projekt në kuadër të disa lëndëve. Andaj, grupi u pajtua se me të drejtë këto janë paraqitur në RVV si pika të forta të studimit.

Disa nga vërejtjet të cilat u adresuan në lidhje me RVV-në dhe pikat e dobëta të programit të studimeve që u potencuan nga përfaqësuesja e studentëve Albina Vuthi janë:

- Angazhim apo arritje më e gjerë tek palët e interesuara (edhe organizatat e ndryshme të shoqërisë civile);
- Caktimi/emërimi i një zyrtari përgjegjës për angazhim ose arritje tek palët e interesuara;
- Shqyrtimi i mundësisë së një provimi pranues në nivel master për studentët që vijnë nga studimet bachelor që janë jashtë profesioneve të cilat janë të parashikuara me Rregulloren për Pranim dhe Transfer në Studimet Master të Kolegjit ESLG;
- Shtimi i numrit të orëve të ushtrimeve në lëndën Arkitektura e Qëndrueshme;
- Programi i studimeve të bëhet start-up inkubator për bizneset në fushën e paluajtshmërive;
- Me organizuar më shumë simpoziume dhe punëtori me palët e interesuara si GIZ;

College ESLG  
Nazim Gafurri 33  
Tel: 038 602 405  
M: 044 159 867  
E-mail: [info@eukos.org](mailto:info@eukos.org)



# College ESLG

- Idetë e studentëve të gjeneruara në kuadër të lëndëve të shëndrrohen në projekt ide dhe këto projekt ide të shëndrrohen në nisma konkrete në bashkëpunim me palët e interesuara dhe donatorët ndërkombëtar;

Në anën tjetër përfaqësuesja e studentëve Eljesa Arifi dha këto vërejtje:

- Kolegji ESLG dhe programi master të kontribuojë në krijimin e Standardeve të Cilësisë për Vlerësimin e Paluajtshmërive;
- Të themelohet një kurs hyrës për studentët master ku ju tregohen të gjitha pritjet e programit;

Prof. Asoc. Dr. Visar Hoxha

Prof. Asist. Dr. Islam Hasani

Albina Vuthi, përfaqësuese e studentëve

Eljesa Arifi, përfaqësuese e studentëve



College ESLG  
Nazim Gafurri 33  
Tel: 038 602 405  
M: 044 159 867  
E-mail: [info@eukos.org](mailto:info@eukos.org)